



RAPORT MONITORIMI
SHQIPËRIA 1 EURO
Nentor 2020 -Janar 2021

Shqipëria



AUTOR
ANILA SALIANJI

QENDRESA
QYTETARE



National Endowment
for Democracy
Supporting Freedom around the World

www.qeverisja.qq.com.al



1. Fillesat e nismës “Shqipëria 1 Euro” nga Qeveria Berisha

Shqipëria 1 Euro është një nismë e ndërmarrë nga qeveria Berisha, e prezantuar publikisht në vitin 2006 e cila ka hyrë në fuqi me anë të VKM nr. 162, datë 07.03. 2007 “Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore¹”. Sipas kësaj VKM-je, tarifa e qerasë apo e enfiteozës, e objekteve të ndërmarrjeve ose shoqërive shtetërore, ku qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi kryen një veprimtari prodhuese, do të jetë 1 euro kontrata. Kriteret e konkurrimit, për këto kontrata do të përcaktoheshin rast pas rasti nga Këshilli i Ministrave. Sipas kesaj nisme, pasuritë dhe resurset publike do të vireshin në dispozicion të investitorëve për një afat nga 50 deri në 99 vjet. Po ashtu theksohet se në rast se subjekti, nuk realizon kushtet e kontratës, atëherë tarifat e qerasë përlllogariten sipas tarifave të përcaktuara nga qeveria për qeratë, si dhe penalizohet me gjobë, në masën e garancisë së depozituar, në çastin e lidhjes së kontratës. Vlera e garancisë për këto subjekte ishte 10% e vlerës së investimit të marrë përsipër në konkurrim dhe garancia kthehet pas përfundimit të investimit.

Gjatë prezantimit të saj, kryeministri i kohës u shpreh se do t'u ofrohen investitorëve troje publike dhe lehtësira të tjera me një euro. Nëpërmjet kësaj nisme synohej që Shqipëria të bëhej një vend konkurues në rajon për thithjen e investimeve të huaja, si dhe të stimulohej shtimi i vendeve të reja të punës. Por mbi të gjitha, synimi kryesor i nismës “Shqipëria 1 Euro” ishte krijimi i parqeve industriale dhe parashikohej se do të ndërtoheshin minimalisht gjashtë parqe të tilla në Shkodër, Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan dhe Vlorë.



¹Qwndra e Botimeve Zyrtare <https://gbz.gov.al/eli/vendim/2007/03/07/162/7955ca79-6c77-435a-bcd4-45ac4e1adaa2>



Kjo nismë u kundështua fuqishëm nga opozita e kohës të cilët e akuzonin kryeministrin e atëhershëm se ishte duke shituar Shqipërinë për skrap. Zv/kryeministri Erion Bracce, në kohën që ishte në opozitë, gjatë një interpelance në parlament me kryeministrin Berisha për këtë nismë shprehej se:



“Ju shpallët nismën ‘Shqipëria 1 euro’ si iniciativën tuaj personale për të tërhequr investitorët e huaj të investojnë në Shqipëri. Tani duket sikur vendi është në shitje, ndërsa ju ngjani gjithnjë e më tepër me atë tregtarin e zotë rom që një herë në muaj thërret mes pazarit më të lirë: U hap thesi!”

2. Rikthimi nga Qeveria Rama i nismës së shumë kontestuar “Shqipëria 1 Euro”

Deklaratat, kundështitë dhe akuzat për këtë nismë u harruan pas ardhjes në pushtet të qeverisë socialiste në vitin 2013. Në 5 shkurt 2014, me VKM nr. 54 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfileozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”², Këshilli i Ministrave vendosi të rikthjejë nismën e famshme dhe shumë të kritikuar nga ana e tyre, “Shqipëria 1 Euro”. Ky vendim, përgjatë dy viteve është ndryshuar gjashtë herë (VKM nr.735 datë 5.11.2014, nr.445 datë 20.05.2015, nr.992 datë 9.12.2015, nr.299 datë 20.04.2016, nr.606 datë 31.08.2016, nr.693 datë 5.10.2016)

Sipas këtij vendimi të Këshillit të Ministrave, pasuritë shtetërore, me sipërfaqe mbi 500 m², u jepen të tretëve edhe me kontrata qiraje, me tarifë simbolike 1 euro/kontrata, me vendim rast pas rasti, të Këshillit të Ministrave. Në vendim thuhet se procedura do të zhvillohet me konkurim dhe subjekti që do të rezultojë fitues duhet që në pasurinë shtetërore të zhvillojë një prej veprimtarive të mëposhtme:

- a) veprimtari prodhuese, me nivele investimi mbi 300 000 000 (treqind milionë) lekë;**
- b) përpunim aktiv të mallrave, që do të sigurojnë jo më pak se 50 vende pune;**
- c) veprimtari të agrobiznesit, si: grumbullim, përpunim dhe shitje të produkteve bujqësore ose blegtorale, me nivele investimi mbi 100 000 000 (njëqind milionë) lekë;**
- ç) veprimtari në fushën e arsimit, mediave me nivele investimi mbi 200 000 000 (dyqind milionë) lekë.**
- d) veprimtari për konstruksion, shërbim mirëmbajtjeje, dekonstruksion të mjeteve detare lundruese me nivele investimi mbi 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë.**
- dh) Biznese FASON me mbi 50 punësime të reja;**

Gjithashtu në vendim parashikohet edhe dhënia me qira të pasurisë shtetërore pa konkurim dhe me çmimin simbolik 1 euro/kontrata, me ofertë "të pakërkuar" kur ka një propozim për zhvillimin e zonave të veçanta, duke investuar vlera mbi 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, me qëllim ngritjen e qendrave të organizuara sociale që ndikojnë për zgjidhjen e problemeve sociale ose për ushtrim të veprimtarive në fushën e sportit a të kulturës apo në fushën e turizmit ose të trashëgimisë kulturore.

3. Sanksionet dhe kushtet e prishjes së kontratës

Një ndër ndryshimet që iu bë kësaj nisme ishte edhe **vlera e garancisë, nga 10% të vlerës së investimit që ishte në VKM nr. 162 të vitit 2007 në vetëm 2% të vlerës së investimit**, si dhe u vendos gjobë në vlerën 50.000 lekë në vit për ccdo vend pune të pahapur nga angazhimi i marrë përsipër. Gjithashtu për mosrealizim të vlerës totale së investimit në periudhën e parashikuar në kontratë, subjekti qiramarrës gjobitet me 10% të vlerës së investimit të perealizuar. Nëse edhe pas 6 muajve investimi nuk realizohet, kontrata zgjidhet nga institucioni shtetëror që e ka lidhur atë, duke marrë gjobë, në masën e garancisë së depozituar në atë periudhë. Pas këtyre veprimeve, në marrëveshje midis palëve, kontrata e qerasë mund të rilidhet me tarifa qeraje standarte.

Në kërkesën tonë për informacion drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe konkretisht Drejtorisë së Administrimit të Pronës Shtetërore, në pyetjen se nëse ka pasur raste të nderprerjes të kontratës për shkak të mosrespektimit të kushteve të saj, ky institucion përgjigjet: “asnjë nga kontratat e qirasë me çmim simbolik 1 Euro Kontrata, nuk është zgjidhur për shkak të mosrespektimit të kushteve kontraktore”

4. Monitorimi i kontratave të lidhura me vlerën simbolike 1 Euro

Sipas VKM nr 54 datë 5.2.2014, organi përgjegjës për monitorimin e kontratave të qerasë është vetë institucioni që e ka lidhur atë kontratë. Pra, kjo do të thotë që monitorimi bëhet nga njësitë monitoruese që janë institucionet shtetërore, shoqëritë tregtare dhe ish-ndërmarrjet shtetërore që kanë në administrim objektet e dhëna me qira ose enfiteozë. Këto institucione ndjekin në vijueshmëri respektimin e kushteve të kontratave të qirasë ose të enfiteozës dhe çdo gjashtë muaj hartojnë akte raportimi. Për

çdo kontratë të lidhur, në fund të 6-mujorit të parë, brenda datës 15 korrik, dhe në fund të vitit, brenda datës 20 janar, njësia monitoruese ka për detyrë të dërgojë në degën e shoqërive publike pranë prefekturës përkatëse, një raport të hollësishëm për ecurinë e këtyre kontratave.

Degët e shoqërive publike pranë prefekturave, në momentin që marrin në dorëzim raportet nga njësitet monitoruese, duhet të krijojnë regjistrin për përdorim nga të tretët të pronës publike dhe mbi bazën e të dhënave të regjistrit bëhet përmbledhja e të gjitha kontratave që ka ajo prefekturë. Kjo përmbledhje dërgohet në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe në fund kjo ministri bën një përmbledhje në rang vendi për të gjitha kontratat me tarifë simbolike 1 Euro që janë lidhur nga ccdo institucion në Republikën e Shqipërisë.

Kjo skemë monitorimi ka dy problem themelore. Së pari njësitet monitoruese të institucioneve që kanë lidhur kontratat nuk kanë kapacitetet për të bërë një monitorim të detajuar të respektimit të kushteve të kontratës dhe institucionet më të specializuara si Prefekturat apo Ministria e Financave dhe Ekonomisë i marrin këto të dhëna të mirëqëna dhe nuk bënë asnjë verifikim të tyre. Së dyti, institucionet që kanë lidhur kontratat janë në kontakt të drejtpërdrejtë me qeramarrësit dhe mundësitë e korrupsionit apo të ndërhyrjeve nga subjektet që kanë përfituar kontratat janë shumë të mëdha. Ky fakt është vënë në dukje edhe nga auditimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit, ku theksohet se mbas lidhjes së kontratave të qirasë, njësitet që administrojnë pronën publike, nuk realizojnë një proces të plotë monitorimit. Këto njësi mjaftohen vetëm me monitorimin e pagesave mujore që kryhen nga Administratorët e këtyre shoqërive shtetërore, dhe jo në monitorimin e zbatimit të kushteve të kontratës. Kjo përforcohet me faktin se kontratat e qerasë me vlerë 1 Euro të nënshkruara në vitin 2015-2016, të cilat janë marrë në auditim nga KLSH kanë sjellë përfitim të padrejtë për 10 shoqëri dhe të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në shumën prej 2,466,681,000 lekë.³

³ RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I PËRPUTSHMËRISË TË USHTRUAR NË: MINISTRINË E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES DHE NJËSITË E VARËSISË, TIRANË [SHQIPERIA%201%20EURO/12_mzheets_raport_14_06_2017_web_4034.pdf](#)



5. Fitimi i së drejtës së pronësisë të aseteve të përfituara me qera me tarifë simbolike 1 Euro

Qeveria ka vendosur të ndërhyjë në vendimin e saj "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes" duke përfshirë mënyrën sesi do të kalojë tek privati edhe grupi i pronave që mbulohen nga kontratat e qerasë 1 euro. Referuar ndryshimeve nënvizohet se pasuritë shtetërore të dhëna me kontratë qeraje me tarifën 1 euro/kontrata, i shiten në mënyrë të drejtpërdrejtë kontraktuesit nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike,

Kështu në variantin e parë kontraktori mund të privatizojë pronën që i është dhënë me qira 1 euro nëse është konsumuar të paktën 5 vite kontrata, dhe në rast se vlera e investimit të

kryer prej tij është mbi 150% e vlerës së truallit, ka respektuar kushtet e kontratës dhe nuk ka detyrime ndaj shtetit. Në rastin e dytë kur nuk janë plotësuar 5 vite kontratë vendimi përcakton se mund të bëhet privatizimi në çdo kohë, nëse kontrata është e vlefshme dhe brenda afatit të përcaktuar në kontratë, në rast se vlera e investimit të kryer prej tij është mbi 750 % e vlerës së truallit; nga ana e kontraktuesit janë respektuar kushtet e tjera të kontratës dhe ai nuk ka detyrime ndaj shtetit.

Pasi investimet e kryera nga kontraktuesi janë miratuar nga ministri përgjegjës për ekonominë, ky i fundit i propozon Këshillit të Ministrave dhënien e miratimit për fillimin e



procedurave të privatizimit të objektit, sipas përcaktimeve të kontratës (objekt, truall nënobjekt, truall funksional, linja teknologjike, makineri, pajisje etj.), duke parashikuar edhe shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave, që ka miratuar kontratën e qirasë me tarifën 1 euro, pas nënshkrimit të kontratës së shitjes.

Kërshtu, subjektet që kanë përfituar një kontratë qeraje me tarifën simbolike 1 Euro kanë të drejtën për të privatizuar pronat që kanë në përdorim si më poshtë:

- Në rastet kur shoqëria qiramarrëse ose enfiteozëmarrëse ka kryer investime në përputhje me planbiznesin dhe në masën mbi 150% të vlerës së truallit, pas 5 vitesh subjektit i lind e drejta e privatizimit të objektit të kontratës;
- Në rastet kur shoqëria qiramarrëse ose enfiteozëmarrëse ka kryer investime në përputhje me planbiznesin dhe në masën mbi 750% të vlerës së truallit, subjektit i lind e drejta e privatizimit të drejtperdrejte objektit të kontratës, pa mbushur 5 vjet;
- Në rast se subjekti, që ka lidhur një kontratë qiraje/enfiteozë me të drejtë zhvillimi, realizon kushtet e parashikuara në kontratë, subjektit i lind e drejta e paraqitjes së kërkesës për blerjen e truallit, objekt i kontratës së qirasë/enfiteozës.

6. Subjektet që kanë përfituar kontrata me vlerë simbolike 1 Euro

Sipas të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Administrimit të Pronës Shtetërore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pas kërkesës sonë për informacion, që prej vitit 2014 kur kjo nisme u rrijetësua nga qeveria e re socialiste dhe deri në fund të vitit 2019 është dhënë me qeraje me tarifë simbolike prej 1 Euro kontrata një sipërfaqe totale prej 975.050 m², nga të cilat 87000 m² janë objekt dhe pjesa tjetër është truall.

Këto kompani kanë marrë angazhimin për të krijuar 2698 vende të reja pune, dhe nëse bëjmë një përlogaritje të thjeshtë është dhënë më së pari 361.4 m² pronë publike për të krijuar një vend të ri pune. Këto

kontrata kryesisht janë lidhur me një afat 20 vjecar dhe me shumë lehtësira për privatizimin e tyre madje edhe për më pak se psë vjet nga firmosja e kontratës.

Vlera e investimit që subjektet përfituese të këtyre kontratave kanë marrë përsipër është afërsisht 5.4 miliardë lekë (rreth 43 milionë euro)

Kontratat me tarife 1 Euro

Nr .	Emertimi	Vend ndodhja	Njesia e administrimit të pronës së dhëne me qira	Data e lidhjes së kontratës	Afat i në vite
1	KURUM shpk	Elbasan	N.P.Celiku	25.04.2011	20
2	Berat Konfeks shpk 1	Berat	Beratekx sh.a.	26.07.2011	20
3	Diva Al shpk	Durrës	NPN Durres	31.05.2012	10
4	Victoria Invest shpk	Elbasan	NPÇ	28.08.2013	20
5	LIBEREST shpk	Librazhd	Dr. Pergj.Rezervav e Materiale te Shtetit	05.11.2014	20
6	Calzaturificio Alb.	Shkodër	Duhan Cigare	16.12.2014	20
7	The Star sh.p.k.	Durrës	Prodhim Veshje	17.12.2014	20
8	MITO by C.Firenze	Berat	Berateks SHA	05.06.2015	20
9	MSP TRADE shpk	Durrës	P.Veshje sh.a.	30.06.2015	20
10	Berat Konfeks shpk 2	Berat	Beratekx sh.a.	22.07.2015	20
11	LUBIMA shpk	Bulqizë	Bashkia Bulqizë	31.07.2015	20
12	MUKA shpk	Elbasan	Nd. Prodhimit Çelikut	20.08.2015	20
13	LORENZO shpk	Korcë	Agjencia e Rezervave të shtetit, Plasë, Korçë, DPRMSH	05.10.2015	20
15	The Star sh.p.k.	Durrës	Prodhim Veshje	21.03.2016	20
16	Partizani sha	Tiranë	Ministria e Mbrojtjes, Reparti Ushtarak 4030	23.03.2016	20



17	KASEL shpk	Durrës	Prodhim Veshje	28.04.2016	20
18	Bomira	Berat	Bashkia Çorovodë	24.08.2016	20
19	ROZAF (kont.bashkuara)	Elbasan	Agjencia e Rezervave të shtetit, Labinot, Elbasan, DPRMSH	12.11.2018	20
20	Al Alto Gradim. SHPK	Durrës	NPV Durres	14.12.2017	10
21	Alba Cozmetik 2014	Durrës	Dega e Shoqërive Publike	30.01.2018	20
22	Naim Tragaj Group	Durrës	Ministria e Bujqësisë	19.04.2019	20
23	Concort Investment	Saranë	Porti Detar	02.08.2019	20
24	Fundjave Ndryshe	Tiranë	Ndermarrja Industriale Nr.1	15.08.2019	20
25	Alliance Resource	Elbasan	Nd. Prodhimit Çelikut	13.09.2019	20
26	Blu Imperial	Qafemolle, Dajt	Ministria e Mbrojtjes,	14.10.2019	20
27	Rozafa shpk, Cekrez	Cekrez, Gramsh	Ministria e Mbrojtjes	27.12.2019	20
28	MTSC SHPK	Tiranë	Ndermarrja Industriale Nr.1	14.10.2019	20
29	Rozafa shpk, Perrenjas	Perrenjas	Ndermarrja Industriale Nr.1	27.12.2019	20
30	SV MEGA SHPK	Durrës	Hekurudha Shqiptare sha	21.02.2020	20
31	Ceren Ismet Shehu shpk	Tirane	Ministria e Mbrojtjes	06.05.2020	20



7. Problematikat dhe shkeljet e evidentuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit

K Kontrolli i Larte i Shtetit ka zhvilluar në vitin 2017 një auditim në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtise dhe Sipërmarrjes dhe në njësitë e varësisë së këtij institucioni, konkretisht Drejtorinë e Administrimit të Pronës Publike dhe ka evidentuar një mori problematikash lidhur me kontratat e qerasë me tarifën simbolike 1 Euro.

Nga auditimi dokumentacionit të shoqërive për marrje me qira të pasurisë publike, u konstatua se, favorizimi i tyre nëpërmjet kontratave simbolike favorizuese "1 euro", është i pa argumentuar dhe i pajustificuar, me tregues, teknikë, ekonomiko-financiarë, dhe tregues të tjerë që lidhen me burimet e punësimit, e konkretisht:

-Nuk ka të dhëna për prodhimin vjetor, për të ardhurat shpenzimet dhe fitimin vjetor me qëllim garantimin e vazhdimësisë së aktivitetit të çdo shoqërie të interesuar për marrje me qira të pasurisë publike.

-Nuk ka të dhëna apo tregues për burimin e financimit të investimeve, makineri pajisjeve dhe ambienteve të tjera të shërbimit për trajtim të punëtorëve në se do sigurohen nga fitimi i aktivitetit ekzistues, apo me kredi bankare për të qenë të besueshëm në realizimin e shpenzimeve dhe çeljen e vendeve të reja të punës si kusht për përfitim të kontratës favorizuese "1 euro", duke lenë shteg për përdorim të mjeteve financiare jashtë kanaleve të bankës.

-Nuk ka të dhëna për aktivitetin aktual të subjekteve që kërkojnë të zgjerojnë prodhimin nëpërmjet objekteve shtesë si, treguesit ekonomikë, prodhimin e realizuar, koston për njësi shpenzimet e prodhimit dhe të ardhurat nga shitja, për të garantuar vazhdimësinë e treguesve pozitivë ekonomikë edhe në kontratën e re me kushte favorizuese "1 euro"; -Plan bizneset e shoqërive nuk janë të shoqëruar me treguesit e punësimit dhe të dhëna demografike për popullsinë e zonës dhe shkallën e papunësisë

si një burim potencial për të garantuar numrin e fuqisë punëtore në objektin që kërkohet të merret me qira për zhvillim apo zgjerim aktiviteti.

- Nga auditimi konstatohet se në 7 raste është shpallur fitues subjekti i vetëm konkurrues, të cilët kanë deklaruar se do kryejnë investime tepër minimale që variojnë nga 2.8 deri 31 % të vlerës së përcaktuar në VKM nr. 54, datë 05.02.2014, duke mos justifikuar dhe argumentuar në këtë mënyrë edhe çeljen e vendeve të reja të punës.

- Nga auditimi i procedurave të dhënies me qira të pasurisë publike, konstatohet se përgjithësisht procedurat për dhënie me qira të pasurisë publike kanë filluar në bazë të kërkesave të subjekteve private për marrje me qira të objekteve pronë publike, dhe jo mbi bazën e publikimit në buletinet e APP për të informuar çdo subjekt të interesuar për zhvillimin apo zgjerimin e aktivitetit në pasurinë publike që aktualisht është e lirë, apo mbi një strategji afat mesme apo afatgjatë të këtij procesi. Kjo mënyrë veprimi ka sjellë si pasojë paracaktimin e shoqërinë fituese, pa u zhvilluar konkurrencë, për të marrë ofertën më të leverdisshme për zhvillimin e pronave përkatëse.

- Nga auditimi konstatohet se, para fillimit të procedurës së dhënies me qira të pasurisë publike në asnjë rast nuk është llogaritur dhe përcaktuar vlera e kontabile e objektit apo e indeksuar me çmimet e tregut, për ta vendosur si kusht kualifikimi që investimi në pasurinë e paluajtshme të jetë mbi 200 për qind të vlerës së shpallur për konkurrim. Kjo mangësi është në kundërshtim me pikën 4 të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, kapitulli I “Pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë, kriteret e konkurrimit, e drejta, kompetencat dhe afatet”, pika 4 “Kriteret e konkurrimit për dhënien me enfiteozë të pasurisë shtetërore”.

Sipas KLSH, këto mangësi nuk justifikojnë propozimet dhe miratimet e kontratave favorizuese simbolike “1 euro”, pasi nuk janë argumentuar me vlerën e investimeve, treguesit ekonomikofinanciarë, burimet e financimit të investimeve dhe çeljen e vendeve të reja të punës, duke sjellë si pasojë përfitim të padrejtë nga 10 shoqëri dhe të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në shumën prej 2,466,681,000 lekë, të cilat konsiderohen të paarkëtueshme. Më fund KLSH rekomandon Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj”, deri “Largim nga shërbimi civil” për Drejtorin e Drejtorisë së Administrimit të Pronës Publike.



8. Rekomandime



Nga ana e MFE, nuk ekziston një data-baze, ku në bashkëpunim me Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, të bëhet evidentimi i të gjithë objekteve pronë shtetërore të mundshme për t'u dhënë me qira, duke i promovuar në formë elektronike në ëeb-in e MFE, para bizneseve vendase apo të huaja, si një mundësi për zhvillimin e aktivitetit ekonomik të vendit.



Në kërkesen tonë për informacion drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në pyetjen nëse është krijuar një databazë e të gjitha pronave të lira të cilat potencialisht mund të jepen me qera me anë të kësaj skeme, sipas sugjerimeve të KLSH të vitit 2017, na u dha si përgjigje se duhet ti drejtohem Drejtorisë së Kadastrës pasi Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike nuk e ka një informacion të tillë. Prandaj ne sugjerojmë që të krijohet një databazë e të gjitha pronave që mund të jepen me qera nëpërmjet tarifës simbolike 1 Euro dhe kjo të jetë publike për të gjitha subjektet e interesuara.



Mbas lidhjes së kontratave të qirasë, njësitë që administrojnë pronën publike, nuk realizojnë një proces të plotë monitorimit. Duhet të ndryshojë menjëherë skema e monitorimit të këtyre kontratave dhe duhet të jetë strukturë hierarkike monitoruese duke filluar nga institucioni që ka lidhur kontratatën dhe deri tek Ministria e Ekonomisë dhe Financave ose të kontraktohen kompani auditimi të jashtme të pavarura për ta kryer këtë monitorim.



Nga auditimi është konstatuar se nuk ka patur "garë konkurruese" pasi është paraqitur vetëm një subjekt në garë. Për këtë shkak, sugjerojmë që këto kontrata duhet të lidhen nëpërmjet një gare reale dhe transparente midis bizneseve të interesuara.

#QËNDRESË MIRËQEVERISJE